



AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

I

Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar

“LURA HOTEL “ Shpk

(Hotel Mövenpick)

KAPITULLI I

Emri,forma,selia,kohezgjatja

Neni 1 Data e themelimit dhe Emri

1.1 Me efekt nga data 12.07.2021, nga themeluesi;

Shoqëria “LURA” Sh.p.k, nje shoqeri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe e themeluar rregullisht ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe e regjistruar pranë organeve tatimore me Nipt Nr.j61901122Q, me Perfaqesues Ligjor **z. Dod Doci** i biri i Llesh-it i datelindjes 10.12.1956, lindur ne Diber dhe banues ne Tirane, me dokument identifikues leternjoftim id nr.personal F61210040F, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,

THEMELOHET Shoqeria “**LURA HOTEL “, shpk**, Emertimi tregetar “**Hotel Mövenpick**”, (ne vijim "Shoqeria") e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk", I cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqeri me përgjegjësi te kufizuara.

1.2 Ortaket e Shoqërise ("Ortaket") gezojne përgjegjësi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqërise te perfaqesuar ne kuota.

1.3 Ne te gjithë dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqëria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:

1.3.1 Fjalet "Shoqeri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "Shpk"





1.3.2 Numri Unik i Identifikimit te Subjektit NUIS

1.3.3 Adresa e regjistruar

1.3.4 Pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.

1.3.5 Kapitalin e regjistruar te Shoqerise dhe kapitalin e paguar te Shoqerise

Neni 2 Forma Ligjore

2. 1 Shoqeria eshte nje entitet Shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar"), ne perputhje me ligjin Nr.9910, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("Ligji I Shoqerive").

Neni 3 Selia

3. 1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Kompleksi Lura 2, Hotel Mövenpick , Lalz Durres.

Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi Brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4 Kohezgjatja


4.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pacaktuar.


KAPITULLI II

Neni 5 Objekti I shoqerise

5.1 Objekti aktivitet I Shoqerise do te jete te kryej cdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptar, vecanerisht sa me poshte:

- Aktivitet ne fushen e turizmit, hapja dhe manaxhimi i hoteleve, e godinave dhe ambjenteve ne te cilat ushtrohet aktivitet hotelier.
- Hapja dhe manaxhimi i sallave te konferencave ne kuader te aktivitetit hotelier.
- Hapja, manaxhimi dhe funksionimi i qendrave te rekreacionit, me ose pa profil te dermo-estetikes, trajtimit te lekures dhe trupit, per masazhe, spa, mirembajtje trupore, fitness, dhe pishina.



- 
- Aktivitet ne fushen e qiradhenies se zyrave, 2 ambjenteve tregtare dhe/ose pasurive te tjera te paluajtshme qe i perkasin hotelit.
 - Kryerja e tregtimit, prodhimit dhe perpunimit te mallrave, qe kane te bejne me aktivitetin e hotelerise.
 - Hapja e manaxhimi i bareve dhe restoranteve brenda struktures hoteliere si edhe ushtrimi i aktivitetit ne fushen e kembimit valutor dhe te mallrave te çmuar, bizhuteri, apo sende me vlere te kuotuar ne burse.
 - Hapja dhe mbajtja e aktiviteteve te lojrave te fatit e kazinove, brenda strukturave hoteliere dhe çdo gje tjeter qe perfshijne fushat e mesiperme, te lejuara nga ligji.
 - Plazh Privat
 - Kryerja e operacioneve ekonomike e juridike, industriale, prodhuese, tregtare qe lidhen drejt per drejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqerise, brenda kuadrit te dispozitave ligjore per realizimin e cdo biznesi te pershtatshem ne arritjen e qellimit te shoqerise.

Neni 6 Ndryshime

6.1 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar, Kuotat e kapitalit Themeltar

Neni 7 Kapitali themeltar


7.1 Kapitali I Shoqerise eshte i shprehur ne kapital ne para, ne vleren leke 100.000 leke (njeqind mije) qe do te perdoren si kapital i shoqerise plotesisht te nenshkruara dhe te pashlyera.

7.2 Ky kapital eshte i barabarte me 1(nje) Kuota. Kontributet mund te behen ne natyre dhe ne vlere monetare, ne perputhje me ligjin.

7.3 Kapitali I Shoqerise dote shlyhet nga Ortaket, ne proporcion me pjeset e tyre takuese, brenda nje periudhe prej 1 viti nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKB

Neni 8 Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat





8.1. Ortaket e shoqerise dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri jane si meposhte:

Shoqëria "LURA" Sh.p.k, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e organizuar dhe e themeluar rregullisht ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe e regjistruar pranë organeve tatimore me Nipt Nr.j61901122Q.

zoteron 1(nje) kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit te Shoqerise, ne vlere nominale 100.00,00 Leke(njeqind mije leke)

Neni 9 Zvogelimi ose Zmadhimi I Kapitalit Themeltar

9.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligj it te Shoqerive.

9.2 Zmadhimi I kapitalit mund te realizohet ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.

9.3 Rritja e kapitalit dote behet me kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vi era e tyre nominale do te paguhet plotesisht.

9.4 Zmadhimi I kapitalit nuk dote dobesoje pjesen e interest te Ortakeve ne Kapitalin e Shoqerise, pervecse kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, vendim I cili meret me nje shumice prej 3/4-t e votave.

9.5 Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/Administratoret te bejne blerjen e kuotave perkatese apo pjese te tyre dhe ti anullojne ato.

Neni 10 Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

10.1 Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuotat e Shoqerise.

10.2 Cdo Ortak dote kete te drejta vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ("Asambleja e Pergjithshme") ne perpjestim me vleren nominale te kuotes qe zoteron. Cdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shpemdardjen e fitimeve te Shoqerise, nese Asambleja e Pergjithshme vendos te shperndaje fitimet, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, per cdo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligj it te Shoqerive.





10.3 Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.

10.4 Te drejttat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri per keto Kuota.

10.5 Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne pergjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne. Ortaket nuk mbajne pergjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata realizojne).

10.6 Shoqeria nuk mban rgjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

Neni 11 Transferimi I pjeseve te Kapitalit

11.1 Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve.

11.2 Ne rast se nje Ortak do te shese, transferoje, ose perdore ne menyra te ndryshme pjese apo te gjithe kuoten e tij Ortaku tjeter dote kete te drejten e parablerjes, kundrejt blesesve te tjere. Nese Ortaku me te drejte parablerjeje do te kete bere nje oferte dhe kjo oferte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere Ortaku tjeter dote rishikoje oferten e bere dhe do t'i beje Ortakut qe shet nje oferte te dyte. Nese edhe kjo oferte e dyte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere ky i fundit (Ortaku qe shet) nuk do te kete te drejte te shesi kuoten tek nje bleser tjeter me cmim me te ulet se cmimi i ofruar nga Ortaku i preferuar ne oferten e dyte.

11.3 Cdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligj it te Shoqerive dhe duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit.

KREU IV

Asambleja e Pergjithshme

Neni 12 Kompetencat

12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve/ Ortaku I Vetem , eshte organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.



Neni 13 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

13.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten I here ne vit.

13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

13.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere mete larte se 5% e te gjitha aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme dote vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe dot' i paraqitet Asamblese, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise. 13.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje Ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

13.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i para itet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, I pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

13.6 Ortaket dote organizojne takime me Administratoret te pakten nje here ne vit me qellim vleresimin e veprimteve te kryera nga Administratoret, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre, perfshire ceshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord.

13.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

Neni 14 Menyra e Thirrjes se Mbledhjeve

14.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

14.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve.

14.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i



mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithe Ortaket bien dakort.

14.4 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

14.5 Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Rezoluta e propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t' u dergohet Ortakeve me poste, korrier, telecopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) dote marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe iu eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke I kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me rezoluten shprehin me shkrim kundërshtite e lyre ne lidhje me rezoluten dhe i'a kthejne administratoreve te Shoqerise. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet me tre te katertat e votav@ te ortakeve pjesemarrës.

14.6 Secili prej Ortakeve ka te drejten te votoje ne perputhje me kuoten e zoteruar prej tij ne kapital.

14.7 Vendimet e meposhtme dote miratohen me miratimin e Ortakeve qe zoterojn te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise: (i) Pagesa e cdo dividendi ne kesh apo natyre Ortakeve te Shoqerise; (ii) Nenshkrimi i marreveshjeve financiare ne lidhjeme Shoqerine apo nxjerrja e instrumentave te borxhit nga Shoqeria; (iii) Blerja e cfaredolloj kuote apo interesi tjerter ne cdo biznes dhe siper marrje; (iv) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise sic eshte percaktuar ne Nenin 7 te kesaj Marreveshje; (v) Ndryshime dhe amendime te ketij Akti Themelimi; dhe (vi) Likuidimi apo shpëmdarja e Shoqerise.

14.8 Atehere kur ligji e kerkon kete, rezolutat e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter public Shqiptar. Ne rast se keto rezoluta miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).

14.9 Ortaket dote njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.

14.10 Administratorët duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.





Neni 15 Perjashtimi nga e drejta e votes

15.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:

- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

15.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

KREU V

Administratoret

Neni 16 Bordi I Administratoreve dhe kompetencat

16.1 Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.

16.2 **z. Dod Doci** i biri i Llesh-it i datelindjes 10.12.1956, lindur ne Diber dhe banues ne Tirane, me dokument identifikues leternjoftim id nr.personal F61210040F , me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, do te jete Administratore e Shoqerise.

16.3 Kohezgjatja e funksionit te Administratoreve eshte per nje periudhe prej 5 (Pese) vitesh, me te drejte rinovimi kontrate per periudhe te ngjashme kohore, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit), mete drejte ripertesitje te ketij mandati.

16.4 Menjehere pas pranimit te emerimit te tyre, Administratori(et) njohin nese maredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje rezolute te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.



16.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Adminsitratorët me shumice te thjeshte votash.

16.6 Nese Administratoret e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo vepdm.eve te tj era, ceshtja do te referohet tek Ortaket.


16.7 Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fi zikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria u rimbursom Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Adminsitratorit(eve) ne vende qe nuk jane Brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

Neni 17 Kompetencat dhe detyrimet

17 .1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- i. Thirrjen e Asamblese se Pergj ithshrne, ne rastet e specifikuara ne nenin 13.
- ii. Menaxhimimn e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.
- iii. Perfaqesimin e Shoqerise
- iv. Kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.
- v. Pergatitjen dhe firmosj en e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese s e Pergjithshme.
- vi. Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, kur eshte e nevojshme.
- vii. Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
- viii. Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

17.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne same mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.





Neni 18 Detyrimi I besnikerise dhe pergjegjesia

18.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e pergjithshme të detyrimit të besnikerisë, sipas nenëve 14, 15, 16, 17 e 18 të Ligjit të Shoqërive, Administratoret detyrohen:

- i. të kryejnë detyrat e tyre e percaktuara në ligj ose në këtë Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecante ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- ii. të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të percaktuara në këto dispozita;
- iii. të vlerësojnë me pergjegjësi ceshtjet për të cilat merret vendim;
- iv. të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
- v. të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm

18.2 Administratoret gjatë kryerjes së detyrave të tyre pergjigjen kundrejt shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve perkatëse, veprim apo mosveprim është kryer në mirëbesim.

18.3 Në rast të shkeljes së detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 të këtij neni, Administratori është i detyruar të demshperblejë Shoqërinë, për demet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë Shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të p.a.rregullta. Ai ka barrën e provës për të vertetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standarteve. Kur shkejta është kryer nga më shumë se një Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

18.4 Në vecanti, Administratori është i detyruar të demshperblejë Shoqërinë, për demet, neqoftese në kundërshtim me Ligjin e Shoqërive kryen veprimet e mëposhtme:

- i. I kthen Ortakëve kontributet;
- ii. I paguan ortakëve interesa apo dividente;
- iii. I shperndan asetet Shoqërisë;
- iv. lejon që Shoqëria të vazhdojë aktivitetin e saj, kur duhet të kishte parashikuar që kjo e fundit nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet e saj.
- v. jep hua.





KREU VI
Auditimi Financiar I Shoqerise

Neni 19 Eksperti Kontabel I Autorizuar

19.1 Ortaket mund te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar per te audituar Shoqerine.

19.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII
Aktiviteti Shoqerise

Neni 20 Viti ekonomiko-financiar

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillion ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31- te te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

Neni 21 Mbajtja e Llogarive

21.1 Shoqeria dote mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 22 Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

22.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit dote caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, marreveshjen e Ortakeve dhe me ligjet e zbatueshme.

22.3. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shpemdaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:





- i. asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
- ii. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem.

22.4. Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpemdajja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shpemdaj a e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

22.5. Administratoret pergjigjen ndaj Shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

KREU VIII

Modifikimi I Formes Ligjore. Prishja

Neni 23 Modifikimi I Formes Ligjore


23. 1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.


23.2. Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 24 Prishja e Shogerise

24. 1 Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (i i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- (iii) hapje e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr. 9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe;





24.2 Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723 date 3.0 5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" . Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njofton vendimin e kesaj te fundit per regjistrim.

KREU IX
Te ndryshme

Neni 25 Largimi I ortakut

25.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, dote rregullohen nga nenet IOI, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 26 Te tjera

26.1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

Nenshkrimi I Themeluesve/Ortakut/eve

LURA HOTEL (Hotel Mövenpick) Shpk

Shoqeria Lura sh.p.k

Dod Doci

Dod Doci



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER XHEVAHIRE H. BRAHAJ



DATE 12/07/2021
NR REP 4368

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 12/07/2021 , para meje Notere XHEVAHIRE H. BRAHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.1, ISMAIL QEMALI, GENER 2, NR.8, HYRJA NR.2, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Shoqëria LURA SH.P.K., regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS J61901122Q, me adresë Rruga Mustafa Matohiti, Pallati Abao, Shk Nr.1, Kati 2., përfaqësuar nga Administratori Dod Doçi, atësia Llesh, amësia Dile, shtetas Shqiptar, lindur në Armollë, Dibër dhe banues në Tiranë, me adresë I Qemali; Nd. .; H. 6; Ap. 14; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 10/12/1956, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033770709 dhe nr. personal F61210040F.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, “Akt Themelimi dhe Statut” Shoqëria LURA HOTEL Emertimi Tregtar (Hotel Mövenpick)”, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

XHEVAHIRE H. BRAHAJ

Taksa e Puljes
U PAGUA